



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

18.02.18
OLSI VANGU



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 230/3 prot.

Vlorë, më 15.02.2018

VENDIM

Nr. 9, datë 14.02.2018



PËR
ORGANIGRAMËN E UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORË

Mbështetur në shkronjën ç, pika 1 në nenin 38 në Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Udhëzimin nr 27, datë 29.12.2017 të MASR, "Për strukturën e brendshme akademike dhe administrative të IPAL-ve", në Vendimin e Senatit Akademik nr.3 datë 01.02.2018 "Për përcaktimin e kategorive të personelit ndihmësakademik dhe personelit administrativ", si dhe në vendimin e Bordit të Administrimit nr. 2 datë 09.02.2018 "Për përcaktimin e kategorive të personelit administrativ", Senati Akademik i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, në mbledhjen e datës 14.02.2018

VENDOSI:

1. Të miratojë organigramën e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, e cila ndodhet bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Organigrama e miratur sipas këtij vendimi të jetë pjesë e statutit të UV-së sipas nenit 33, të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".
3. Vendimi i SA-së me nr. 10, datë 27.01.2017, si dhe cdo akt tjetër i brendshëm i UV-së që bie ndesh me këtë vendim shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI



